



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 37288/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Mimoza Ahmetaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 të Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të lartë Publikë dhe deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë zyrtaret, Ligji nr. 3/L -151, e në bazë të nenit 73, 74, 195, 199, të LMK me dt. 03.05.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA : Mimoza Sylejman Ahmetaj, e lindur më 01.10.1971 në Prishtinë, ku dhe tani jeton në rrugën B. Diellit zona qender llam 8/8, me profesion këshilltare në zyrën e kryeministrit, e gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

E pandehura në cilësinë e këshilltares politik në zyrën e kryeministrit, ka qenë e obliguar që në afatin ligjor prej 60 ditësh nga dita e marrjes së funksionit, ta deklarojë pasurinë në Agjensionin Kunder Korrupsionit, ku e njëjta nuk e ka deklaruar pasurinë e vetë, të përcaktuar sipas këtij ligji deri më dt. 09.08.2011

Me këtë të ka kryer vepër kundërvajtëse nga neni 7 të Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të lartë Publikë dhe deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë zyrtaret, Ligji nr. 3/L -151, andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirologarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 13 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirologari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi të dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr.01-4114/11 të dt 26.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku dhe është marrë konkluzioni për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Gjatë procedurës u dëgjua e pandehura e cila në deklaratën e saj, deklaroi se sa i përket pozitës time si këshilltare në zyrën e kryeministrit ja kam filluar më dt. 08.06.2011, kam shku në Amerikë, ku kam qëndruar një kohë, dhe nuk e kam ditë se pas pranimit të punës se re, duhet ta paraqes pasurinë, po kam menduar se duhet vetëm një herë në vit.

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjuar parashtuesi i kërkesës Afrim Atashi i cili në deklaroi se kërkesa është e bazuar, ngase e pandehura është emëruar në pozitën e këshilltares politike në zyrën e Kryeministrit nga data 08.06.2011, dhe nga ajo kohë nuk e ka paraqitur pasurinë ku është e obliguar në bazë të nenit 7 të Ligjit mbi prejardhjen e pasurisë, ku kanë kaluar më shumë se 60 ditë nga dita e pranimit të detyrës.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të kësaj lloji dhe të ngjashme, andaj u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Fatmir Behlani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.